

# Statistikat afatshkurtra

## Shërbimet - Tremujori III 2019


**Tiranë, më 13 Dhjetor 2019:** Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

### Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 4,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 4,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




### Transport, Magazinim dhe Posta

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Posta, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 3,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 5,0 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)




### Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 22,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 24,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 29,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)




**Bar, Restorante**

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 5,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 10,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Bar-Restorante (%)




### Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 3,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 17,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 5,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)




### Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 0,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike (%)




**Agjenci udhëtimi**

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e tretë 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018.

Fig. 7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)



**Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2015=100)**

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.III 2019 (2015=100)	III.19 / III.18 (%)	Tr. III 2019 (2015=100)	III.19 / II.19 (%)
G	45+46 +47	Tregti	120,9	4,3	113,2	2,7
H	49-53	Transport dhe Magazininim	149,1	3,9	124,7	0,9
I	55.1	Hotele	278,8	22,5	218,8	35,3
I	56	Bar-Restorante	202,5	5,4	180,7	3,5
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	97,0	3,8	92,6	2,0
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	244,2	2,8	249,8	40,6
N	79	Agjenci udhëtimi	180,1	2,6	167,8	2,0

**Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2015=100)**

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja		Tr.III 2019 (2015=100)	III.19 / III.18 (%)	Tr.III 2019 (2015=100)	III.19/ III.18 (%)
G	45+46+47	Tregti	113,3	0,3	117,2	4,8
H	49-53	Transport dhe Magazininim	115,3	3,5	133,4	5,0
I	55.1	Hotele	191,1	24,0	215,0	29,4
I	56	Bar-Restorante	169,8	0,6	196,3	10,1
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	108,1	17,5	99,3	5,8
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	119,9	3,7	142,5	0,3
N	79	Agjenci udhëtimi	150,1	2,4	174,3	2,5

# Metodologjia

## Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2017, realizuar nga INSTAT.
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante).

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

## Në Shërbime

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

#### **Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjeve neto* - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i Shitjeve neto* - Objektiv i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime.

*Numri i të punësuarve* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

*Indeksi i Numrit të punësuarve* - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojuara.

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

#### **Përshtatja sezonale**

**Përshtatja** sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2,1. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori 1 2006 - Tremujori III 2019. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.